



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1665/14 Prot

Tiranë, më 29/12/2014

V E N D I M

Nr. 6, datë 29/12/2014

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe neneve 80-104 të Ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit "Eurosig" sh.a,

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhërit nr.153, datë 01.10.2014 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është ushtruar kontroll administrativ, duke u njoftuar paraprakisht, pranë kontrolluesit "Eurosig" sh.a, me objekt: Zbatimi nga ana e kontrolluesit i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri gjatë kryerjes së aktivitetit të tij.

"Eurosig" sh.a është person juridik jopublik, që operon në tregun e sigurimeve bazuar në ligjin nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit, dhe risigurimit" dhe akteve të tjera normative të dala në zbatim të tij nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) dhe gjatë ushtrimit të aktivitetit mbledh, përpunon, ruan të dhëna personale për subjektet e të dhënave personale.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale pas shqyrtimit të procesverbalit të kontrollit administrativ dhe provave të administruara konstaton se:

1. Nga kontrolluesi "Eurosig" sh.a është shkëlur detyrimi i përcaktuar nga neni 18 i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

- Kontrolluesi "Eurosig" sh.a, Tiranë nuk realizon informimin e subjekteve të të dhënave në policat e sigurimit ("policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta", "policë sigurimi kufitare", etj), si dhe në policat jo të detyrueshme ("sigurimi ndaj zjarrit", "sigurimi i ofertës", "sigurimi kasko", etj.

Kontrolluesi "Eurosig" sh.a, Tiranë nuk ka bërë një përshkrim të plotë të "politikave të privatësisë" në publikimin e bërë në faqen e tij në internet, me qëllim informimin e personave që vizitojnë faqen, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, masat e sigurisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Autoriteti i Komisionerit thekson se informimi i subjekteve në lidhje me përpunimin e të dhënave të tyre personale nga kontrolluesi është shumë i rëndësishëm, në mënyrë që këta të fundit të kenë dijeni mbi: personat që njihen me të dhënat e tyre, qëllimin dhe mënyrën e përdorimit të të dhënave, kujt do t'i përhapen të dhënat, mbrojtjen e privatësisë, etj. Për këtë arsye çdo individ/subjekt i të dhënave personale ka të drejtën e informimit dhe mbrojtjes së duhur të të dhënave të tij personale. Përpunimi i të dhënave personale duhet të lejohet për aq sa është i nevojshëm, i drejtë, i ligjshëm dhe proporcional.

Publikimi i rubrikës *“politikat e privatësisë”* është i rëndësishëm me qëllim informimin e individëve subjekte të të dhënave personale që aplikojnë online ose personave që vizitojnë këtë faqe, mbi mënyrat e mbledhjes, përpunimit, ruajtjes, si dhe masat e marra për sigurinë e të dhënave personale. Në këtë rubrikë duhet të publikohen të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë. *“Politikat e privatësisë”* synojnë sensibilizimin e publikut mbi rëndësinë e mbrojtjes së privatësisë dhe të drejtat që gëzojnë në këtë fushë.

2. Nga kontrolluesi *“Eurosig”* sh.a është shkelur detyrimi i përcaktuar nga neni 20 i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar si dhe udhëzimi nr. 19 datë 03.08.2012 *“Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”*.

- Kontrolluesi *“Eurosig”* sh.a në Marrëveshjen *“Frontig”* që ka lidhur me korrespondentin *“Imperial Claims Services-Albania”* për *“Trajtimin e dëmeve të mjeteve motorike me targa të huaja”*, gjatë zbatimit të së cilës të dhënat personale të klientëve të kontrolluesit përpunohen nga kompania korrespondente, nuk ka parashikuar rregulla dhe kushte për detyrimin e përdorimit të ligjshëm të të dhënave personale nga kompania përpunuese *“Imperial Claims Services-Albania”* të parashikuara në nenin 20 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar.

Sipas përcaktimeve të këtij neni, kontrolluesit e të dhënave personale për të garantuar përdorimin e ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave, kur futen në marrëdhënie me palë të treta në rastet e delegimit të shërbimeve, duhet të kushtëzojnë këto palë dhe të vendosin detyrime ndaj tyre, për përpunimin e të dhënave vetëm në përputhje me udhëzimet e kontrolluesit, të dhënat të mos transmetohen, përveç kur kontrolluesi e lejon një gjë të tillë, të kushtëzojë palën e tretë për të marrë të gjitha masat e sigurisë, sipas këtij ligji dhe të punësojë operatorë, të cilët kanë detyrimin për ruajtjen e fshehtësisë, të krijojnë, në marrëveshje me kontrolluesin, kushtet e nevojshme teknike dhe organizative për përmbushjen e detyrimeve të kontrolluesit, për të siguruar të drejtat e subjekteve të të dhënave personale, t'i dorëzojë kontrolluesit, pas përfundimit të shërbimit të përpunimit, të gjitha rezultatet e përpunimit dhe dokumentacionit, që përmban të dhëna, ose t'i mbajë apo t'i shkatërrojë ato me kërkesë të kontrolluesit.

3. Nga kontrolluesi *“Eurosig”* sh.a është shkelur neni 21 i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar .

- Kontrolluesi *“Eurosig” sh.a*, Tiranë nuk ka plotësuar, të gjitha mangësitë e konstatuara nga grupi i inspektimit dhe të lëna në proces verbal, në lidhje me deklaratimet e bëra në Formularin e Njoftimit, në zbatim të nenit 21 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar, si më poshtë vijon;

Rubrika 3.1: nuk është deklaruar përpunimi i të dhënave personale për kategorinë “aksionerë”

Rubrika 4.1: nuk është deklaruar kategoria e të dhënave personale që përpunohen për kategorinë “aksionerë”

Rubrika 6.1: nuk është deklaruar qëllimi i përpunimit “menaxhim i burimeve njerëzore”, për kategorinë “nëpunës” dhe nuk ka deklaruar përpunimin e të dhënave personale “Imazhe” nëpërmjet përdorimit të kamerave të Vëzhgim-Regjistrimit (CCTV).

Mos përditësimi i Formularit të Njoftimit nga ana e kontrolluesit, lidhet me transparencën e kontrolluesit në raport me subjektet e të dhënave personale, nëpërmjet “Regjistrimit Elektronik të Njoftimeve”, i cili mbahet nga Komisioneri. Subjektet e të dhënave personale nëpërmjet regjistrimit, njihen me kategoritë e të dhënave personale që kontrolluesi mbledh, përpunon, mjetet e përpunimit, sigurinë e të dhënave personale etj. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nëpërmjet “Regjistrimit Elektronik të Njoftimeve”, mbikëqyr dhe monitoron kontrolluesit për përpunimin e të dhënave personale, në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

4. Nga kontrolluesi “Eurosig” sh.a është shkelur detyrimi i përcaktuar nga neni 27,28 i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar .

- Kontrolluesi “Eurosig” sh.a në “Rregulloren e brendshme” të tij nuk ka përfshirë rregulla lidhur me përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, si dhe kohën e mbajtjes së të dhënave personale të “klientëve të larguar” etj.

- Kontrolluesi “Eurosig” sh.a përdor sistem vëzhgimi me kamera (CCTV) për të cilin nuk ka hartuar rregulla të përfshira në “Rregulloren e Brendshme” apo në një rregullore të veçante duke mos respektuar kërkesat e Udhëzimit nr. 3 datë 05/03/2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “Përpunimi i të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Mungesa e rregullave dhe e hartimit të rregullores së veçantë, në të cilën të jenë shprehur përcaktimet dhe detyrimet që rrjedhin nga nenet 27, 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të cilat detyrojnë kontrolluesin të marrë masa teknike dhe organizative për përcaktimin e funksioneve ndërmjet njësive organizative dhe operatorëve për përdorimin e të dhënave, përcaktimin e aksesit, përcaktimin e personave të autorizuar që hyjnë në të dhënat dhe programet e ndryshme që aplikon kontrolluesi, tregojnë për mungesën e masave të sigurisë dhe shkallën e ulët të konfidencialitetit që ka kontrolluesi në procesin e mbledhjes, përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave personale. Dokumentimi në formë të shkruar i këtyre masave tekniko-organizative dhe zbatimi i tyre në praktikë është garanci për mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me ligjin, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së kontrolluesit.

Përfaqësuesi i kontrolluesit, nëpërmjet proces verbalit nuk parashtroi ndonjë pretendim.

Më datë 23.09.2014 kontrolluesi “Eurosig” sh.a me shkresën zyrtare nr.607/3 Prot. ka njoftuar Komisionerin për zbatimin e pikës 1, të Rekomandimit nr. 69, datë 25.08.2014, të

Komisionerit, dhe nuk është shprehur për zbatimin e pikës 2 të Rekomandimit nr. 69, datë 25.08.2014, të Komisionerit.

Nga kontrolli i faqes online www.eurosig.al të kontrolluesit “Eurosig” sh.a u konstatua se kontrolluesi i është referuar vetëm ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar duke mos bërë një përshkrim të plotë të “politikave të privatësisë” që ndjek si kontrollues, në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Në ambientet e Zyrës së Komisionerit më datë 02.12.2014 u zhvillua seanca dëgjimore me kontrolluesin “Eurosig” sh.a, për paraqitjen e pretendimeve të tij, me qëllim ushtrimin e të drejtës së kontrolluesit, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga Zyra e Komisionerit, në zbatim të neneve 93-96 të Ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999. “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Nga kontrolluesi në seancën dëgjimore u paraqitën pretendimet me shkrim dhe u depozituan një sërë provash të cilat tregojnë reagimin e kontrolluesit në lidhje me rekuperimin e disa prej shkeljeve të konstatuara gjatë kontrollit administrativ dhe konkretisht;

- Nga shoqëria “Eurosig” sh.a dhe Imperial Claims Service-Albania është nënshkruar Aneks Marrëveshje “Frontig” nr. 3573/1 prot, datë 17.10.2014 duke përfshirë kërkesat e nenit 20 të ligjit 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.
- Është përditësuar Formulari i Njoftimit;
- Është nxjerrë Urdhër për hartimin e rregullores së veçantë lidhur me përpunimin e të dhënave personale, sigurinë dhe konfidencialitetin;
- Janë dorëzuar disa kopje të policave (“Policë për sigurimin nga zjarri”, “Policë e sigurimit të vetë mjetit motorik Kaskok”, “Policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”, “Policë sigurimi kufitare”, me disa reflektime të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Komisioneri e vlerëson reagimin e kontrolluesit por, kjo nuk e shmang kontrolluesin nga përgjegjësia administrative për mospërbushjen në kohë të detyrimeve të përcaktuara me ligj.

Si përfundim konkludoj se; shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit administrativ pranë kontrolluesit “Eurosig” sh.a, në kuptim të nenit 39 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar përbëjnë **“kundërvajtje administrative”** dhe sanksionohen me gjobë;

- Kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë.
- Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë

- Kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, të përcaktuar në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze, ato lidhen me të drejtën e subjekteve të të dhënave personale për informim si një e drejtë parësore në zbatim të ligjit, me sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, zbatimin e ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, nenin 39/2 në të cilin parashikohet se; “Personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni”, faktin që kontrolluesi ka qenë bashkëpunues gjatë ushtrimit të këtij kontrollit administrativ dhe ka marrë masa për rikuperimin e disa prej shkeljeve të konstatuara.

PËR KËTO ARËSYE:

Në zbatim të neneve 18/2, 20, 21, 29, 30/2, 31, 39/1/b/ç/d, 39/2, 39/4, 40 e 41, të ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit “Eurosig”sh.a me gjobë në vlerën 20 000 (njëzetë mijë) lekë për shkelje të detyrimit të përcaktuar në **nenin 18** të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

2. Dënimin e kontrolluesit “Eurosig”sh.a me gjobë në vlerën 20 000 (njëzetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në **nenin 20** të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

3. Dënimin e kontrolluesit “Eurosig”sh.a me gjobë në vlerën 20 000 (njëzetë mijë) lekë për shkelje të detyrimit të përcaktuar në **nenin 21** të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar,

4. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30(tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyre të detyrueshme nga zyra e përmbartimit.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

